

NJOFTIM MBI PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË NGA AVOKATIA

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pas publikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të shpalljes së vendeve vakante dhe thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve, Avokati i Popullit ka nisur procedurat e nevojshme administrative. Gjegjësisht, referuar neneve 23 dhe 121 të ligjit nr. 115/2016, me shkresat nr. 02 datë 24.07.2023 dhe nr. 03 datë 24.07.2023 Avokati i Popullit ka kërkuar nga Akademia e Shkencave dhe nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dërgimin e listës me emrat e anëtarëve të Komisionit të Pavarur *Ad Hoc* për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Avokatia.

Ndërkohë, Avokati i Popullit po përfundon përmirësimin e rregullave dhe procedurave për mbarëvajtjen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga Avokatia.